

Ligji mbi Shëndetin dhe Sigurinë

Çfarë duhet të dini

Albanian



This is an **Albanian** language version of leaflet ISBN 978 0 7176 6501 3, published 04/09

Ky është një version i përshtatshëm për internetin i kartës së xhepit që përmban Ligjin mbi Shëndetin dhe Sigurinë, botuar në 04/09

Të gjithë punëtorët kanë të drejtën të punojnë në vende ku rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë së tyre kontrollohen siç duhet. Shëndeti dhe siguria janë që të mos lejohet të lëndoheni ose të sëmureni nëpërmjet punës. Punëdhënësi juaj është përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë, por ju duhet të ndihmoni.

Çfarë duhet të bëjnë punëdhënësit për ju

- 1 Të vendosin se çfarë mund t'ju dëmtojë në punën tuaj dhe të marrin masa për ta ndaluar. Kjo është pjesë e vlerësimit të rrezikut.
- 2 T'ju shpjegojnë në një mënyrë që e kuptoni, se si do të kontrollohen rreziqet dhe do t'ju thonë se kush është përgjegjës për këtë.
- 3 Të konsultohen dhe të punojnë me ju dhe përfaqësuesit tuaj të shëndetit dhe sigurisë për t'i mbrojtur të gjithë nga rreziku në vendin e punës.
- 4 T'ju ofrojnë trajnim pa pagesë mbi shëndetin dhe sigurinë që ju duhet për të kryer punën tuaj.
- 5 T'ju japin pa pagesë çdo pajisje dhe veshje mbrojtëse që ju nevojitet dhe të sigurohen që ato të mbahen në gjendje të mirë pune.
- 6 T'ju ofrojnë banja, vende për t'u larë dhe ujë të pijshëm.
- 7 Të ofrojnë mjedise të përshtatshme për ndihmën e shpejtë.
- 8 Të raportojnë lëndimet e rënda dhe vdekjet në punë në Qendrën tonë të Kontaktit për Incidentet: **0345 300 9923**. Të raportojnë plagosjet e tjera, sëmundjet dhe incidentet e rrezikshme në internet në adresën **www.hse.gov.uk**.
- 9 Të kenë sigurim që ju mbulon ju në rast se lëndoheni në punë ose sëmureni për shkak të punës. Të afishojnë një kopje në letër ose një kopje elektronike të certifikatës aktuale të sigurimit në një vend ku mund ta lexoni me lehtësi.
- 10 Të punojnë me çdo punëdhënësi ose kontraktor tjetër të cilët punojnë së bashku në vendin e punës ose do të kujdesen (si për shembull për punëtorët e agjencive), në mënyrë që shëndeti dhe siguria e të gjithëve të jenë të mbrojtura.

Çfarë duhet të bëni ju

- 1 Duhet të ndiqni trajnimin që keni marrë kur përdorni ndonjë send pune që jua ka dhënë punëdhënësi juaj.
- 2 Duhet të kujdeseni në mënyrë të arsyeshme për shëndetin dhe sigurinë e vetes tuaj dhe të tjerëve.
- 3 Duhet të bashkëpunoni me punëdhënësin tuaj për shëndetin dhe sigurinë.
- 4 Duhet t'i thoni dikujt (punëdhënësit tuaj, mbikëqyrësit ose përfaqësuesit të shëndetit dhe sigurisë) nëse mendoni se puna ose masat e papërshtatshme po e vendosin shëndetin dhe sigurinë e dikujt në rrezik.

Nëse ka ndonjë problem

- 1 Nëse jeni të shqetësuar rreth shëndetit dhe sigurisë në vendin tuaj të punës, flisni me punëdhënësin tuaj, me mbikëqyrësin ose me përfaqësuesin e shëndetit dhe të sigurisë.
- 2 Ju mund të shihni edhe faqen tonë të internetit për informacion të përgjithshëm rreth shëndetit dhe sigurisë së në punë.
- 3 Nëse, pasi të keni folur me punëdhënësin tuaj, ju përsëri jeni të shqetësuar, mund të gjeni adresën e autoritetit tonë vendor zbatues për shëndetin dhe sigurinë dhe Shërbimin Këshillues për Punësimin Mjekësor nëpërmjet faqes së internetit të HSE-së (Ekzekutivi i Shëndetit dhe Sigurisë) **www.hse.gov.uk**.

Siguria ndaj zjarrit

Ju mund të merrni këshilla për sigurinë ndaj zjarrit nga Shërbimi i Zjarrit dhe Shpëtimit ose nga oficeri i vendit tuaj të punës përgjegjës për zjarret.

Të drejtat e punësimit

Mësoni më shumë rreth të drejtave të punësimit tuaj në: **www.gov.uk**.

Informacion shtesë

Kjo fletëpalosje gjendet në www.hse.gov.uk/pubns/bools/lawleaflet.htm.
Informacioni gjendet në formate të tjera.

© Crown copyright 2009 Nëse dëshironi ta përdorini sërish këtë informacion vizitoni www.hse.gov.uk/copyright.htm për hollësi. Botuar për herë të parë në 04/09